

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"TURTLES" Sh.p.k.**

- Z.Ergi Luan Shkëlqimi , me nr ID : J70521065L, datëlindje 21.05.1997 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në: lagj. 28 Nentori, rr: Lublin Dilja, Elbasan 3001.
- Z. Kei Arian Çala, me nr ID : J60420089C, datelindje 20.04.1996 qytetar Shqiptar, me vendlindje ne Elbasan dhe banim ne lagj: Shenkoll, rr: Fetah Cankja, Elbasan 3001.

Kemi vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është "TURTLES" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: TIRANE, Rruga "Perlat Rexhepi" , Zona Kadastrale 8270, vol.90, faqe 135, numer pasurie 4/194-N 1/1. Tirane.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**


Shoqëria ka objekt veprimtarie si me poshtë:

- Veprimtari ne fushen e restoracionit: Piceri, Catering, BarKafe, Delivery .

-Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze të vendimit të Asamblesë se Ortakeve.

**Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000,000 (njemiljon leke) i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.



## Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Ergi Luan Shkëlqimi , me nr ID : J70521065L, datëlindje 21.05.1997 qytetar Shqiptar, me vendlindje në Elbasan dhe banim në: lagj. 28 Nentori, rr: Lublin Dilja, Elbasan 3001, të cilit i përket një kuotë me vlerë nominale 500.000 leke , që i korrespondon 50% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Kei Arian Çala, me nr ID : J60420089C, datelindje 20.04.1996 qytetar Shqiptar, me vendlindje ne Elbasan dhe banim ne lagj: Shenkoll, rr: Fetah Cankja, Elbasan 3001, të cilit i përket një kuotë me vlerë nominale 500.000 leke , që i korrespondon 50% të kapitalit të shoqërisë.

## Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Kei Çala, me nr ID : J60420089C, datelindje 20.04.1996 qytetar Shqiptar, me vendlindje ne Elbasan dhe banim ne lagj: Shenkoll, rr: Fetah Cankja, Elbasan 3001.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.





## Neni 9- Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.


## Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

## ORTAKËT

Z. Ergi Shkëlqimi

Ergi Shkëlqimi



Datë 01.11.2024

Z. Kei Çala

KEI ÇALA 